



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 15 qershor 2011
Nr. ref.: VMP121/11

VENDIM PËR VAZHDIM TË MASËS SË PËRKOHSHME

në

Rasti nr. KO 119-10

Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë të neneve 14 (1) 6, 22, 24, 25 dhe 27 të Ligjit për të
Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, Nr. 03/L-111, i 4 qershorit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Hyrje

1. Më 20 dhjetor 2010, Gjykata Kushtetuese e lejoi masën e përkohshme në lidhje me kërkesën e lartpërmendur. Në vendimin e saj, Gjykata, *inter alia*, kishte vendosur:
 - I. TË LEJOJË masë të përkohshme nga 22 dhjetori 2010, në kohëzgjatje prej jo më shumë se tre (3) muaj, dhe
 - II. TË PEZULLOJË MENJËHERË zbatimin e neneve 14 (1), 6, 22, 24, 25 dhe 27 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, Nr. 03/L111, të datës 4 qershor 2010, në kohëzgjatje të njëjtë.

Korrespondenca nga Kuvendi i Kosovës

2. Pasi që iu dorëzua Kuvendit vendimi për të lejuar masën e përkohshme, Kryetari i Kuvendit i shkroi Gjykatës Kushtetuese më 24 janar 2011, duke informuar se, për shkak që Kuvendi ka qenë i shpërndarë, nuk ka qenë e mundur të përgjigjet në atë kohë në lidhje me kërkesën.
3. Në letër, Kryetari i Kuvendit të Kosovës gjithashtu e pranoi se Kuvendi ishte në dijeni për lejimin e masës së përkohshme për një periudhë tre (3) mujore. Gjykata prandaj, më 21 mars 2011, e vazhdoi masën e përkohshme deri më 22 qershor 2011.
4. Pastaj, Kuvendi u përgjigj në lidhje me kërkesën më 16 maj 2011. Në lidhje me këtë, Gjykata mori përgjigjen konkretisht nga Komisioni i Kuvendit për Legjislacion, të datës 11 maj 2011.
5. Gjykata ka parasysh:
 - i. Faktin që Kuvendi i Kosovës ka qenë i shpërndarë gjatë periudhës kur është nxjerrë urdhri i parë;
 - ii. Kufizimet kohore me të cilat është ballafaquar Kuvendi për t'u përgjigjur në kërkesë; dhe
 - iii. Nevojën për të shqyrtuar përgjigjen e Kuvendit e cila tanimë është pranuar.

VENDIM

Gjykata, pas shqyrtimit të çështjes më 14 qershor 2011, njëzëri

VENDOS

- I. Të vazhdojë afatin kohor të vendosur nga Gjykata në Vendimin e saj të parë, të 22 dhjetorit 2010, për një periudhë shtesë prej katër muajsh - deri më 23 tetor 2011,
- II. Të mbetet e përkushtuar në këtë çështje;
- III. Ky vendim do t'u komunikohet Kuvendit të Kosovës dhe parashtruesit të kërkesës dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. Dr. Enver Hasani